



Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenin 40, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen vokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e mbështetje të nenit 42 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 3, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023, për Administratë të Hapur në Komunë, e konform nenit 15 lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336 dhe nenit 23, paragrafi 1 të Rregullores për Transparencë të Komunës së Suharekës, 01-Nr-016-84791, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miraton këtë:

## **Projekt-V E N D I M**

### **Neni 1**

Me këtë vendim miratohet Plani i Veprimit për Transparencë në Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2027.

### **Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i veprimit për transparencë në Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2027, i hartuar nga grupi punues i themeluar me vendimin e Kryetarit të Komunës 01-Nr-016-67788 të datës 19.10.2023.

### **Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në Suharekë.

### **Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

## **KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Mr.ec Bexhet KUÇI**

**01-Nr-\_\_\_\_\_**

**Me datë\_\_\_\_\_**